



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Integrim Evropian
Mbledhja nr. 88

Prishtinë, dt. 13.06.2024, në orën 9:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Rrezarta Krasniqi, Fjolla Ujkani, Agon Batusha, Alban Bajrami, Shqipe Isufi, Driton Hyseni dhe Time Kadrijaj.

Munguan: Fridon Lala, Elmi Reçica dhe Blerta Deliu-Kodra.

I ftuar: z. Besnik Bislimi, zëvendëskryeministër i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha.

Mbledhjen e kryesoi Rrezarta Krasniqi, Kryetare e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, e hapi mbledhjen.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 07.06.2024;
3. Raportimi i z.Besnik Bislimi, zëvendëskryeministër i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog;
4. Shqyrtimi i Programit Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE) 2024-2028, i ftuar z. Besnik Bislimi, zëvendëskryeministër i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog;
5. Votimi i raportit me rekomandime për Projektligjin nr.08/L-275 për rrugët dhe për amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
6. Votimi i raportit me rekomandime për Projektligjin nr.08/L-287 për Këshillin e Sigurisë të Republikës së Kosovës dhe për amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

7. Votimi i raportit me rekomandime për Projektligjin nr.08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-197 për zyrtarët publikë dhe për amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
8. Votimi i raportit me rekomandime për Projektligjin nr.08/L-289 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe për amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
9. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 07.06.2024

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Raportimi i z. Besnik Bislimi, zëvendëskryeministër i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog

Kryetarja, tha se ju kemi ftuar sot që të na raportoni lidhur me përmbushjen e obligimeve të institucioneve tona në procesin e integritimit evropian, si dhe proceset tjera të cilat bien në domenin e punës dhe përgjegjësisë tuaj.

Besnik Bislimi, zëvendëskryeministër i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog, tha se fillimisht do të prezantojë për të arriturat e deritanishme në zbatimin e agjendës evropiane ERA 2, deri në fund të vitit 2023. Plani i veprimit ERA2, ka përfshirë gjithsej 15 prioritete dhe 341 reforma konkrete, ku nga këto deri në fund të vitit që lamë pas, janë zbatuar 245.

Një numër i rëndësishëm i ligjeve janë miratuar gjatë kësaj periudhe, që tashmë po zbatohen dhe do të përmendja Kodin e Procedurës Penale, Ligjin për financimi e subjekteve politike, Ligji për deklarimin, kontrollin dhe origjinën e pasurisë të zyrtarëve publikë, Ligji për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Ligji për zyrtarë publikë dhe pagat në sektorin publik, Ligji për parandalimin e dhunës në familje dhe dhuna në baza gjinore, Ligji për zgjedhjet etj.

Në vazhdim, tha se disa reforma kanë nisur të zbatohen në vijimësi, si: Strategjia për sundimin e ligjit; Strategjia për parandalimin e terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm; Strategjia për migrimin; Strategjia për reformën e administratës publike; Strategjia për luftimin e dhunës në familje; Strategjia për energjinë, për ujëra dhe parkun kombëtar “Bjeshkët e Nëmura”. Një numër i madh i reformave konkrete janë realizuar dhe po zbatohen në vazhdimësi. Është krijuar portal i shërbimeve E-Kosova, që po zgjerohet çdo ditë me shërbime të reja që po ofron, si dhe në zvogëlimin e barrës administrative përmes thjeshtimit, bashkimit të shfuqizimit të rreth 8% të lejeve dhe të licencave për operatorë ekonomikë. Është arritur zbatimi i plotë i legjislacionit për

zonat e veçanta të mbrojtura, është zvogëluar numri i deponive ilegale nëpër komuna dhe janë trajnuar shumë inspektorë për menaxhimin e mbeturinave.

Për segmentin e tregut dhe ambientit për të bërë biznes, theksoi se është funksionalizuar Gjykata Komerciale, pastaj është themeluar Njësia për informimin e bizneseve, lidhur me standardet. Janë mbajtur 10 sesione këshilluese, bizneseve për certifikim dhe zbatim të standardeve dhe është rritur mbulueshmëria e kredive të reja për mes fondit “Kosova për garanci të kredive”.

Te drejtësia dhe siguria është institucionalizuar bashkëpunimi me EUROPOL-in, janë trajnuar prokurorë dhe gjyqtarë, për krimet ekonomike dhe financiare, është avancuar infrastruktura komunikuese e policisë, është funksionalizuar qendra e pritjes së përkohshme për emigrantë, janë mbikëqyrë emërimet për nivele të larta dhe shumë tjera. Te punësimi dhe arsimit janë punësuar 4000 persona në vit nga masat aktive të tregut të punës, është mbështetur formalizmi i vendeve të punës dhe punësimi për gra dhe persona me aftësi të kufizuara. Ka pasur përmirësim të sigurisë dhe shëndetit në punë, për shkak të rritjes së numrit të inspektimeve dhe rritjes së inspektimeve të përbashkëta mes institucioneve të policisë dhe Administratës Tatimore të Kosovës. Agjenda e reformave evropiane ERA2, tashmë është përmbyllur dhe ky përmban raportin përfundimtar të zbatimit të tij. Treguesit, realizimi që nuk është përfunduar ende, janë bartur në Programin kombëtar për integrim evropian dhe do të vazhdojnë të monitorohen. ERA1 ishte zbatuar në periudhën nëntor 2016 deri në dhjetor 2019. Zbatimi i saj ka qenë 45% dhe niveli i realizimit të ERA2 qëndron te 72%. Kështu Republika e Kosovës po dëshmon se është gati të avancojë në integrimin evropian, duke arritur gradualisht përaftrim të plotë me standardet e BE-së.

Pasi përfundoi me prezantimin për të arriturat deritanishme në zbatimin e agjendës evropiane ERA 2 deri në fund të vitit 2023, kërkoi të kalojë në pikën tjetër.

Prezantimin e Programit Kombëtar për Integrim Evropian 2024-2028, pasi u dakorduan me kryetaren, filloi me prezantimin dhe theksoi se te PKIE, gjatë vitit që lamë pas, janë paraparë 160 masa dhe qeveria ka miratuar 13 projektligje dhe i ka përcjellë në Kuvendë për miratim dhe Kuvendi deri më tani ka miratuar 5 sosh.

Masat e tjera të rëndësishme që janë zbatuar gjatë vitit 2023, janë: miratimi i agjendës digjitale për Kosovën, miratimi i programit të zbatimit të energjisë; miratimi i programit për bujqësi dhe zhvillim rural 2022-2027, si dhe planit kombëtar për bujqësi organike; miratimi i planit të veprimit 2023-2025 për zbatimin e strategjisë së transportit 2023-2030; miratimi i strategjisë për zhvillim industrial dhe mbështetje të biznesit 2030 dhe planit të veprimit 2023-2025; miratimi i strategjisë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve 2020-2027 dhe plani i veprimit për zbatimin; përgatitja e raporteve 3- mujore financiare dhe të performancës për të gjitha ndërmarrjet publike etj.

Kryetarja, tha se tanimë u bë një vit që Kosova ka masa nga BE dhe ne si Komision kemi kërkuar nga ana juaj dhe gjithashtu nga ana e ambasadorëve të BE-së, se cilat projekte janë pezulluar. Nga disa deklaratat tuaja, në janar të këtij viti, keni thënë se në rrafshin politik masat janë kufizuar vetëm në takimet e nivelit të lartë me përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës. Ndërsa, nëse i referohem

deklaratës së ministrit Murati, i cili ditë më parë ka thënë se për shkak të mungesave të fondeve të BE-së, si rezultat i masave, Kosova është detyruar të ndajë fonde shtesë për një projekt nga të cilat përfitojnë minoritetet. Andaj, kërkojmë që të na numëroni listën e projekteve dhe shumën e projekteve, të cilat janë pezulluar si rezultat i masave ndëshkuese.

Time Kadrijaj, tha se kemi qenë të shqetësuar për vendosjen e masave dhe me këtë po ndëshkohen qytetarët e Kosovës, si dhe me këtë janë ndëshkuar shumë projekte, të cilat nuk kanë mundur të kalojnë pikërisht nga masat e vendosura. 6 miliardë që janë ndarë këtë vitë nga BE për Ballkanin Perëndimor, a do të përfitojë Kosova? Të gjithë e dinë se ne si Komision kemi lobuar në çdo takim, si jashtë vendit po ashtu edhe brenda, me ambasadorë dhe zyrtarë tjerë ndërkombëtarë, që të hiqen masat, jo për hir tuaj, por për hir të proceseve dhe të Kosovës. Ne si Komision e kemi obligim të shohim se sa janë në përputhje të gjitha ligjet me legjislacionin e BE-së dhe të gjitha kërkesat e propozuara, në mënyrë që të kalojnë të gjitha ligjet e harmonizuara, sepse atëherë do të kemi stagnim që në start, sepse nuk do të na lejohet, sepse nëse kemi bërë kërkesë për të qenë pjesë e BE-së, atëherë ato ligje nuk do t'i pranojmë. Atëherë, çka po ndodh me këtë Qeveri dhe cila është rruga që po e trason, qoftë në anëtarësimin në organizata ndërkombëtare, qoftë në synimin që të jemi pjesë e familjes evropiane?

E drejtë e jona është që, si deputetë, ta mbikëqyrim punën e Qeverisë dhe për të parë se ku ka shkelje ligjore. Prandaj, është mirë për t'u koncentruar dhe për t'u marrë parasysh rekomandimet dhe mos të vazhdohet me këto praktika dhe veprime që po i bëni. Na keni sjellë vendin si të izoluar dhe pa perspektivë evropiane. Një Qeveri që nuk e fton askush, na thoni cili ka qenë takimi që e ka pasur kjo qeveri në nivel ndërkombëtar, përveç takimeve në Bruksel. Andaj, pranoni që e keni pranuar edhe asociacionin, edhe që me letrën e zotimeve që e keni shkruar, e keni pranuar para opinionit të gjerë dhe atij ndërkombëtar, që e keni pranuar marrëveshjen me zbatuar në tërësi.

Zëvendëskryeministri, tha se fillimisht kur BE ka vendosur masa ndaj Kosovës, ata kanë vendosur 4 lloje të masave, ku baza ligjore e tyre është shumë diskutabile dhe këto përbëjnë: pezullimin e punës ë trupave të zbatimit të MSA-së; është suspenduar puna në aprovimin e fondeve për IPA 2024; janë pezulluar aprovimet e reja për projektet tona për aplikimet për kornizën investive të Ballkanit Perëndimor dhe është thënë që Kosova nuk do të ftohet në takimet e nivelit të lartë dhe nuk do të ketë vizita bilaterale. Tash, ju mund të analizoni, se në çmasë janë respektuar këto ndalesa të BE-së, kur dihet që ka pas shumë takime të nivelit të lartë, si bilateral, ashtu edhe multilateral.

Asnjë projekt i BE-së nuk është pezulluar që ka qenë duke u zbatuar. Ajo që ka ndodhur është që projektet e IPA-s 2022, që është dashur të kontraktohen nga fillimi, është shtyrë kontraktimi i tyre deri në heqjen e masave. Ne mund t'iu dorëzojmë një listë që ju veç e keni se marrëveshja e IPA-s 2022 është e aprovuar në Komision. IPA 2023 nuk është prekur fare, sepse kjo është mbështetje direkte buxhetore për qeverinë, për problemet me energjinë, që kanë rezultuar si pasojë e luftës në Ukrainë. IPA 2024 është duke u diskutuar në BE, por ajo nuk mund të aprovohet përderisa janë masat dhe nuk janë aprovuar ende 4 aplikimet tona në kornizën investive të Ballkanit Perëndimor.

Ndikimi i masave ka ndikuar në mënyrë indirekte në imazhin e Kosovës dhe në kredibilitetin e BE-së, sepse BE fillimisht i ka vendosur Kosovës masa, në mënyrë të një anshme, për eskalimet që i ka shkaktuar Serbia dhe pastaj ka ekspozuar njëanshmëri në këtë proces, duke mos vendosur masa edhe ndaj Serbisë. Të gjitha veprimet që janë kërkuar nga Kosova me raportimin e z. Borrell, më 3 qershor, Kosova i ka plotësuar dhe ka pasur një tendencë që masat të hiqen dhe për t'u përdorur për të arritur qëllimet tjera të presionit ndaj Kosovës, por nuk ka pasur sukses. Në bazë të informatave që na kanë ardhur, raporti i z. Borrell është parakusht për trajtimin nga ana e Këshillit të Integritimit Evropian, është përpiluar në muajin prill, por ka pasur hezitim që të dërgohet në Komision. Raporti është dashur që të dorëzohet pardje, por një pjesë e Komisionit ka kërkuar pak shtyrje dhe besojmë se do të dorëzohet për aprovim gjatë javës së ardhshme. Informacionet që kam është se përmbajtja e raportit është pozitive dhe rekomandohet heqja e masave.

Kryetarja, tha se unë kam informacione se kanë për të vazhduar masat dhe për ne është shqetësuese, sepse te shtetet tjera, po dalim keq. Më ka rënë të shkojë në takime tjera me ndërkombëtarët dhe jam ndier keq për kërkimin e heqjes së masave prej vendeve që neve na kanë njohur dhe na kanë ndihmuar që ne të jemi shtet i pavarur. Në vazhdim, i tha zëvendëskryeministrit se fole për ERE-në për PKZMSA-në, ndërsa në javën e kaluar kemi pasur këtu në shqyrtim Projektligjin për Këshillin Prokurorial, për të cilin kemi pasur shqetësime nga Zyra e BE-së, sepse nuk janë marrë parasysh asnjë nga propozimet e tyre dhe sot e kemi në shqyrtim Projektligjin për Komisionin e Pavarur për Media, ku as aty nuk është marrë parasysh asnjë propozim nga ndërkombëtarët, kurse ti po thua që jeni duke punuar shumë drejt integritimeve evropiane dhe ku na çon ne si Komision për Integritim Evropian, sepse po ndihem keq kur nuk po merret parasysh asnjë propozim dhe ne po presim të na hiqen masat. Kjo është shumë shqetësuese, andaj a po na shpjegon, pse po ndodh kështu?

Zëvendëskryeministri, tha se ju po thoni se detyrë e juaja është që t'i dërgoni ligjet në kushtetuese. Detyrë e juaja është për të penguar qeverinë të bëjë politika të këqija, por zgjedhja e juaj është për t'i penguar reformat. Nëse BE na ka thënë që Ligji për reformat në administratën publike është crucial për avancim të integritimeve evropiane dhe ju të njëjtën e dërgoni në Gjykatën Kushtetuese, atëherë ju jeni duke e penguar integritimin dhe reformat. Ju po thoni, pse nuk po e pranoni publikisht që ju e keni pranuar asociacionin? Ky konstatim është shumë i rëndësishëm deputete, sepse kjo para mediave po prezantohet si një krim. Në qoftë se ju e keni pranuar asociacionin dhe qenka krim, atëherë nënshkrimi i tij qenka mega krim dhe pranoni që ju paskëshit bërë mega krime, që ne të flasim për krime. Por sikur ne ta kishim pranuar asociacionin, ne sot do të ishim anëtarë të Këshillit të Evropës. Pak më shumë analizë dhe seriozitet nga ana juaj. Na ndihmon të gjithëve në këtë rrugëtim. Është mirë që edhe politikanët në Bruksel janë duke e parë që ata të cilët e kanë nënshkruar asociacionin po e shohin si krim që e kanë bërë dhe kjo pastaj eve na e heq një barrë.

Sa i përket 6 miliardshit të ndarë për Ballkanin Perëndimor, në fakt janë 5.4 miliardë, sepse 9% prej 6 miliardëve shkojnë për sigurimin e financimit dhe ne ato nuk i shohim. Nga 5.4 miliardëve,

shpërndarja bëhet brenda 4 viteve dhe këtë vite bëhet shpërndarja e një paradhënie në vlerë 7% të shumës. Shuma prej 5.4 miliardëve është e ndarë në dy komponentë, ku 40% janë grante. Kurse pjesa tjetër janë kredi me kushte të mira, pastaj e njëjta për secilin vend alokohet në bazë kriterëve, ku njëri kriter është madhësia e popullsisë, dhe kriteri i dytë, është e ardhura për kokë banori. Kosovës i takojnë diku 23.8% e shumës totale, që shkon te kjo pjesë dhe që alokohet përmes çelësit i të ardhurës për kokë banori, që është 40% e totalit, pastaj nga kjo është nxjerrë shuma e totalit që i takon Kosovës dhe është 882 mil. €, prej të cilave gjysma shkon mbështetje direkte buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës. Në vitet në vijim, pjesa tjetër shkon për projekte në Kornizën investive për Ballkanin Perëndimor, ku pastaj në do të bëjmë listën prioritare të projekteve investive, ku janë të caktuara shumë qartë fushat në të cilat ne mund të aplikojmë. Këto mjete janë të lidhura me reforma dhe Kosova ka mbi 107 dhe secila reformë e ka një etiket çmimi dhe në atë moment kur konstatohet se ajo reformë është përmbushur, mjetet transferohen, gjysma në buxhetin e Kosovës, gjysma në alokimin tonë për projektet e kornizës investive të Ballkanit Perëndimor.

Fjolla Ujkani falënderoi zëvendëskryeministrin që i është përgjigjur ftesës, edhe pse ftesa ishte bërë për krejt diçka tjetër. Kishte vërejtje që diskutimi është duke marrë kahe tjetër dhe nuk është diskutuar për atë që të ftohet mbledhja e Komisionit, por sugjeroi që në mbledhjet tjera të radhës, të specifikohet qartë në rend dite, se për çka po ftohet të raportojë zëvendëskryeministri dhe ministrat tjerë, sepse nuk mundemi që para mediave të marrim poenë politike dhe mos t'i diskutojmë çështjet kryesore që janë të rëndësishme për qytetarët e Kosovës. Nëse doni të shihni ku ka arritur kjo qeveri, duhet bërë krahasime. Nuk mund të arrish në një konkludim dhe për të parë çka është mirë dhe çka është keq, nëse nuk bëhet një krahasim dhe ju po bëni një krahasim në vitin 2024, se çka do të ndodhë në vitin 2026-2030. Pse nuk ndaleni për të parë se çka është bërë në vitin 2016 e deri më tani? Nuk ftohet zëvendëskryeministri për t'iu raportuar individëve.

Kryetarja, pastaj edhe **Time Kadrijaj**, thanë se nuk jemi individë, por deputetë, sepse zëvendëskryeministri ka ardhur në një institucion kredibil që të raportojë, për të cilin është i obliguar të raportojë.

Time Kadrijaj, tha se deputetja Ujkani nuk është duke thënë asgjë. 10 minuta je duke folur, nuk ke folur asgjë. Ti veç fole kot. Nuk fole asgjë dhe nuk bëre asnjë pyetje.

Fjalën deshi ta marrë kryetarja e Komisionit, por që pati kundërshtime nga deputetja Ujkani. Më pas, të dy deputetet, Ujkani dhe Krasniqi, kanë debatuar në të njëjtën kohë, përderisa kryetarja e lexonte e-mailin e dërguar për raportim nga zëvendëskryeministri.

Fjolla Ujkani, tha se mënyra edhe qasja qysh e keqpërdorni pozitën si kryetare e Komisionit, ju po e bëni ftesën të vijë zëvendëskryeministri për të raportuar vetëm për opozitën. Ky është niveli që po e sillni ju debatin dhe këtu dua ta mbaj edhe unë. Duhet lënë radhën për të folur edhe të tjerët.

Në vazhdim pyeti zëvendëskryeministrin: Cilat projekte parashihen të merren si prioritet prej Qeverisë, ku do të gjejnë zbatim më të shpejtë, në krahasim me projektet e tjera, të cilat mund të jenë tejet të nevojshme? Por, ja që procedurat administrative mund t'i quajmë, dhe si qëndron harmonizimi i projektligjeve, të cilat ne i miratojmë në Kuvend, të cilat duhet të jenë në përputhshmëri të plotë edhe me projektet që vijnë në Qeverinë e Kosovës.

Zëvendëskryeministri, tha se në raportova në detaje për ERA 2 dhe tash që kemi një rritje prej 60% në implementim në ERA2, në raport me ERA1, pata zero kundërshtime e që për mua është një kompliment. Raportova për programin kombëtar të integrimi evropiane dhe i tregova masat që janë zbatuar dhe pati zero reagim dhe ky është konfirmim i suksesit të qeverisë në zbatimin e këtyre dy masave, por debati shkoi te dialogu, por unë në asnjë moment nuk do ta pengojë opozitën të vendos tema në rend të ditës, në ato shtylla më të forta të Qeverisë, për aq kohë sa neve na sulmojnë te dialogu, ne jemi shumë komfort .Projektet e IPA-s i zbaton BE dhe është përgjegjës nëse ka vonesa në zbatim, nëse ndonjëri nga kontraktorët dështon në implementimin e projektit. Në disa raste nuk ka qenë as faji i BE-së, se për shkak të pandemisë, shumica e projekteve IPA-s 2014- 2015 dhe 2016, janë shtyrë në zbatim. I vetmi moment kur Kuvendi mund të mbështesë Qeverinë në zbatimin e reformave drejt BE-së, është që projektligjet dhe strategjitë, të cilat burojnë nga PKIE, t'i aprovojë me kohë dhe mos të ketë vonesa të pajustificueshme nëpër komisione parlamentare.

Driton Hyseni, i tha kryetares se detyrë kryesore e ke mirë-menaxhimin e punës së Komisionit, kurse sot e bëre të kundërtën dhe shumë keq po ndihemi, se nuk na dhe hapësirë asnjërit prej deputetëve t'i shtrojmë pyetje zëvendëskryeministrin.

Për shkak te obligimeve në Qeveri, zëvendëskryeministri nuk kishte mundësi të qëndronte më tepër në mbledhje. Kryetarja e Komisionit e mbylli mbledhjen, për te vazhduar në mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 10:00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

**Kryetare e Komisionit,
Rrezarta Krasniqi**
